

SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJASNr. ____ prot.
____.12.2019

Prrenjas, më

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatori ekonomik „Rej” shpk me NIPT J93711608Q, me adrese: Lagjia 3, Shetitorja Europa, Pogradec, me administrator Z.Luan Kapri .

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur” shërbime

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-38180-10-03-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Pastrim ,grumbullimin dhe transportin e mbeturinave ne territorin administrativ të Bashkisë Prrenjas 5 vjecar”

Publikime të mëparshme : Buletini i Njoftimeve Publike Buletini Nr. 40 datë 7.10.2019

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme d

Fondi limit: 62,487,791 (gjashtëdhjetë e dy milion e katërqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një) leke pa tvsh.

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1.“**Alko-Impex General Construcion**” shpk me nipt K91326028I, me adrese: Tirane, Rruga “Reshit Petrela”,Kompleksi Usluga, kati i 8, prane stacionit te trenit me perfaqesues ligjor Z.Arbër Abazi me ofertë ekonomike **52,014,418.6** (pesëdhjetë e dy milion e katërbëdhjetë mijë e katërqind e tetëmbëdhjetë pikë gjashtë) **lekë pa TVSH.**

2.“**Korsel**” shpk me NIPT J64104124G, me adrese: Korçe, Objekt Privat, Bulevardi Fan. S. Noli, Perballe Supermarket "Elisabet" me administrator Z.Maksim Fejzulla me ofertë ekonomike **60,593,534** (gjashtëdhjetë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tridhjetë e katër) **lekë pa TVSH.**

3.“**Rej**” shpk me NIPT J93711608Q, me adrese: Lagjia 3, Shetitorja Europa, Pogradec, me administrator Z.Luan Kapri me ofertë ekonomike 49,360,052.6 (dyzet e nëntë milion e treqind e gjashtëdhjetë mijë e pesëdhjetë e dy pikë gjashtë) **lekë pa TVSH.**

4.“**Viola Green**” sh.p.k me Nipt L51928004K me adrese: Tirane, Njesia bashkiake nr.2, bulevardi Zhan D'ark, pallati Wonder, kati 2, me administrator Z.Marsel Shega me ofertë ekonomike 60,613,157.27 (gjashtëdhjetë milion e gjashtëqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e shtatë pikë njëzet e shtatë) lekë pa TVSH.

Janë s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1.“**Korsel**” shpk me NIPT J64104124G, me adrese: Korçe, Objekt Privat, Bulevardi Fan. S. Noli, Perballe Supermarket "Elisabet" me administrator Z.Maksim Fejzulla me ofertë ekonomike **60,593,534**

(gjashtëdhjetë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tridhjetë e katër) **lekë pa TVSH.**

2. **“Viola Green” sh.p.k** me Nipt L51928004K me adrese: Tirane, Njesia bashkiake nr.2, bulevardi Zhan D'ark, pallati Wonder, kati 2, me administrator Z.Marsel Shega me ofertë ekonomike 60,613,157.27 (gjashtëdhjetë milion e gjashtëqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e shtatë pikë njëzet e shtatë) lekë pa TVSH.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. S’kualifikimi i opertorit ekonomik “Korsel” shpk, per arsye se :

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se operatori ekonomik “KORSELI” shpk:

- Nuk ploteson kapacitetet teknike për kualifikim.

Operatori ekonomik **“Korseli” shpk** nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për paraqitjen e mjeti autobot me kapacitet mbajtës 10,000 l.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Nenin 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe Dokumentave Standarde të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e OE “Korsel” sh.p.k nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar si ofertë të pavlefshme.

*Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se **oferta nuk përmban** te sakte dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit, në mbështetje të pikës 3 të nenit 66 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “ Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

*Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me **Nenin 53** të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” i ndryshuar si dhe Dokumentave Standarde të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e OE **“Korsel” sh.p.k nuk është në përputhje** me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar **si ofertë të pavlefshme.***

2. S’kualifikimi i operatorit ekonomik “Viola Green” shpk ,per arsye se :

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se

- Nuk i plotëson kapacitetet teknike për kualifikim.

1. Operatori ekonomik “Viola Green” shpk nuk ploteson pikën 1, germa e, të Kritereve të Veçanta për kualifikim në Dokumentat Standarte të Tenderit, në të cilën kërkohet:

“Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

“Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri”

Vërtetimi i paraqitur “Vërtetim Debie” nr. 7115 prot, dt 13.08.2019 në të cilën deklarohet se “Viola Green” rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime duke përfshirë faturën koherente të muajit Korrik 2019.

Në nenin 27, pika 5 germa c të VKM nr. 914, date 29.12.2014 për: “Miratimin e rregullave te prokurimit publik” përcaktohet: “Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike Autoriteti Kontraktor kërkon:

- *Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka Operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. **Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e Operatorit ekonomik.....”***

Në nenin 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM nr.108, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve familjarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarik të muajit pasardhës të atij të faturuar.”

Sa më sipër, Komisioni i Vleresimit të ofertave gjykon se, me anë të dokumentacionit që ka paraqitur në sistemin elektronik, operatori ekonomik nuk e ka plotësuar kriterin e vendosur në Dokumentat Standarte të Tenderit pasi vërtetimi i paraqitur për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike për kontratën në emër të abonentit nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për periudhën më të fundit para hapjes së ofertave që tashmë ishte maturuar. Proçedura e prokurimit: “Pastrim ,grumbullimin dhe transportin e mbeturinave në territorin administrativ të Bashkisë Prrenjas (5 vjecar)”, është zhvilluar në datë 28.10.2019, ndërkohë që në Vërtetimin e paraqitur nga OSHE deklarohet se Viola Green ka paguar faturën e muajit Korrik 2019.

OE nuk ka sjellë vërtetim që është paguar fatura e muajit Gusht, faturë e maturuar tashmë pasi afatin e fundit të pagesës e ka pasur deri ditën e fundit të muajit Shtator dhe tenderi është hapur në datë **28.10.2019**.

Sa më sipër arsyetuar operatori ekonomik “Viola Green” shpk me dokumentacionin e paraqitur nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike.

2. OE nuk ka paraqitur asnjë dokument që vërteton plotësimin e kriterit nr.7 të kapacitetit teknik:
7.Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur nga Qendra Kombëtare e Licensimit me;

- Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullimin dhe transportim të mbetjeve jo të rrezikshme (kodi III.2.B)
- Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për shërbime ndërhyrëse higjeno-sanitare (kodi II.8.B)

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës)” pasi nuk ka paraqitur Licensë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për shërbime ndërhyrëse higjeno-sanitare (kodi II.8.B).

3. Ka paraqitur dokumenta për mjetet me targa AA709UM nga ku rezulton se ky mjet është i vitit të prodhimit 2006; mjeti me targa AA894OS e vitit të prodhimit 2001; mjeti me targë AA109MX e vitit të prodhimit 2003; mjeti me targë AA209MX e vitit të prodhimit 2004; AA949MV e vitit të prodhimit 2003.

Ndërkohë që në DT është kërkuar: “8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:

- a) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, **i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010**, jo më pak se 2 (dy) copë;
- b) Makina për larjen e rrugëve, (autobot) i pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10000 litra ujë, **i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se 1 (një) copë.**

Sa më sipër, mjetet e OE Viola Green nuk janë në përputhje me kërkesat në dokumentat e tenderit.

4. Ska paraqitur asnjë foto të mjeteve të kërkuara në DST pika 8.1 germa d): “Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit dhe karakteristikat e tij”.

5.OE nuk rezulton të ketë paraqitur mjet fadrome te kerkuar ne piken 8 c) të kriterëve të kapacitetit teknik të DST: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme: c) Fadrome.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se **oferta nuk përmban** të sakte dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit, në mbështetje të pikës 3 të nenit 66 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “ Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me **Nenin 53** të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” i ndryshuar si dhe Dokumentave Standarde të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e OE “**Viola Green**” sh.p.k nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar si ofertë të pavlefshme.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik “**Rej**” shpk me NIPT J93711608Q, me adrese: Lagjia 3, Shtetitorja Europa, Pogradec, me administrator Z.Luan Kapri, **se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme** prej 49,360,052.6 (dyzet e nëntë milion e treqind e gjashtëdhjetë mijë e pesëdhjetë e dy pikë gjashtë) **lekë pa TVSH** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Prrenjas sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 11.11.2019 .

Ankesa: Ka pasur ankese në datë 14.11.2019 . (nuk është marrë në konsideratë ankesa)

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë 20.11.2019.

Ka pasur ankese në datë 18.11.2019 (është marrë në konsideratë pjesërisht ankesa)

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë 25.11.2019.

Rivleresimi është bërë në datë 25.11.2019 .

Ankesa: Nuk ka pasur ankese.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
NURI BELBA